

“TREGOJINI DHE DËSHMOJINI ALLAHUT MË TË MIRËN NGA VETJA JUAJ..!”



A ËSHTË KY MUAJ, MUAJ I AGJËRIMIT APO MUAJ I USHQIMIT?!



PËRSE I KËRKOJMË INTELEKTUALËT E MËPARSHËM?

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 21 - Nr. 3 (241), Mars, 2023

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Me zemër të mirë muajin e Madhërueshëm të Ramazanit!



MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI NË TRIBUNËN E ORGANIZUAR NGA KB ISLAME NË FERIZAJ



(f. 16)

“RAMAZAN MUBAREK”, TRIBUNË FETARE NË PRAG TË MUAJIT TË RAMAZANIT 1444



(f. 14)

“TREGOJINI DHE DËSHMOJINI ALLAHUT MË TË MIRËN NGA VETJA JUAJ..!”



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Falënderojmë Allahun (xh.sh), i Cili na bëri të jemi pjesë e ymetit të Hz. Muhammed Mustafasë (a.s), të cilit i dërgojmë sot dhe në çdo moment të jetës sonë salavatet dhe selamet më të përzemërta.

Për t’i thënë sot e në çdo moment, deri në frymën e fundit, salavatet dhe selamet qofshin mbi ty, ja Resulullah.

Të dashur dhe të shtrenjtë, motra dhe vëllezër besimtarë!

E këshilloj veten time dhe të gjithë ju së bashku me iu frikësuar Allahut (xh.sh), me një frikë që ka në thelbin e saj dashurinë e pakufishme për Zotin e Gjithësisë, mirësitë e bekimet e të Cilit na përfshihjnë në mënyrë të mrekullueshme në çdo ditë dhe në çdo natë, e në veçanti në muajin e madhnueshëm të Ramazanit, që edhe pak ditë po vjen. I lutemi Allahut (xh.sh) të na e bëjë nasib, që ta presim të gjithë së bashku me zemër të mirë e me zemër të bardhë, Ramazanin Mubarek.

Në momentin e parë që ti flet për Ramazanin dhe thua që po vjen Ramazani, atmosfera jote aty brenda vetes ndryshon, sepse shpirti e ndjen dhe mezi pret për të ardhur ajo frymë e madhe e asaj mëshire të pakufishme, me të cilën Allahu (xh.sh) i prezantohet agjëruesve, që në natën e parë. E pastaj, kështu vazhdon deri në ditën dhe në natën e fundit të këtij muaji Mubarek.

Vëllezërit e mi edhe ju motra të nderuara!

Para përmendjes së disa prej veçorive të Ramazanit duhet me e nisë këtë hytbe me disa falënderime; e para me falënderuar Bashkinë e qytetit tonë. Pas sa e sa thirrjeve që ne i kemi bërë institucionit të Bashkisë, që të zbukurojë rrugët e qytetit të Shkodrës për t'u ndjerë atmosfera e Ramazanit, siç ndjehet atmosfera e festave të tjera një ditore me nga një muaj e dy muaj para e mbrapa!?

Me falënderuar përzemërsisht institucionin e Bashkisë, që në çdo lagje të qytetit po vendos fenerë ndriçues dhe po zbukuron rrugët për t’u ndriçuar Shkodra në Ramazan!? Pastaj me falënderuar tregtarët që po ulin çmimet se po vjen Ramazani dhe e bëjnë këtë duke dëshmuar, besimin dhe respektin ndaj muajit të shenjtë!

Çdo firmë e çdo dyqan po uron njerëzit me rastin e këtij Ramazani në këtë qytet musliman, për t’u ndjerë atmosfera pa ndrojtje dhe pa hezitim, që të kapërcehet pragu i asaj politike të kalbur, e cila në këto tridhjetë vitet e fundit ka gërmuar në genet e qytetarëve të këtij vendi për ta vazhduar atë punë që e bëri sistemi komunist, spastrimin e identitetit të shqiptarëve nga Islami!!

Ndërkohë që Allahu i Madhëruar na thotë në Kur'anin Famëlartë: “...Ju nuk duhet të ndiheni inferiorë dhe të keni frikë dhe ndrojtje, sepse jeni besimtarë”.

Pse strukeni cepave dhe keni ndrojtje për të dëshmuar Ramazanin në bizneset tuaja, në ditën tuaj, në komunikimin tuaj

> “Në momentin e parë që ti flet për Ramazanin dhe ti thua që po vjen Ramazani, atmosfera jote aty brenda vetes ndryshon, sepse shpirti e ndjen dhe mezi ç’pret për me ardhë ajo frymë e madhe e asaj mëshire të pakufishme me të cilën Allahu (xh.sh) i prezantohet agjëruesve, që në natën e parë.”

të përditshëm?!

Pse keni ndrojtje xhanëm?!

Ju jeni më të lartit! Mirëpo kur nuk je më i larti në besimin në Allahun (xh.sh) patjetër që do të jesh në fund, i poshtëruar, pa itibar dhe thjesht një pasues i verbër i asaj që të vendoset para duarve.

Muaji i madhnueshëm i Ramazanit është muaji i çlirimit nga idhujtaria, sepse ky muaj, të dashurit e mi, nis me një thirrje të madhe: “O ju të cilët keni besuar”. Që nga momenti i parë që ti i përgjigjesh Allahut (xh.sh) për të agjëruar këtë muaj të Madhnueshëm të Ramazanit, ti je çliruar nga vargonjtë e idhujtarisë, ke hedhur pas krahëve çdo formë të shirkut, sepse i je përgjigjur Atij, i Cili të thërret dhe thotë: “O ju të cilët keni besuar! Për ju është bërë obligim agjërimi”.

Pastaj të falënderojmë përzemërsisht ata që për një arsye a një tjetër që nuk agjërojnë, e respektojnë shenjtërinë e Ramazanit për ta mbajtur të pashuar kujtimin e mirë të gjyshërve tanë, të cilët na thonin, (dhe këtë duhet ta përsërisim vit pas viti), se kur vinte Ramazani në Shkodër, edhe të krishterët ruheshin për të respektuar shenjtërinë e Ramazanit të muslimanëve!

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Ky muaj i madhnueshëm, siç na mëson Pejgamberi (a.s), në shumë e shumë veçori dhe mirësi që i ka, ka dhe pesë gjëra për të cilat Pejgamberi (a.s) urdhëron dhe thotë se: “I janë dhënë ymetit tim, pesë dhunti që nuk i janë dhënë asnjë pejgamberi para tij.

1. Natën e parë të këtij muaji, Allahu i Madhëruar i vështron me mëshirë dhe atë që e vështron me mëshirën e Tij, nuk e ndëshkon kurrë. (Që në natën e parë ti thua " lumi unë, pa filluar agjërimi, Allahu (xh.sh) më shikon me mëshirë." Pejgamberi (a.s) thotë: “Atë që e mëshiron nuk e ndëshkon më kurrë.”

A je ti gati me zemrën tënde me i thanë Zotit të gjithësisë: Ja Rab, Ja Allah! Ja ku e kam zemrën, vështroje zemrën time me mëshirën tënde Ja Rab!)

2. (Fillon agjërimi dhe njerëzit në psikologjinë kanë një shqetësim të madh se iu bëhet goja zeher gjatë ditës. Allahu (xh.sh) i thotë Pejgamberit (a.s.) të na thotë se): **“Shija e gojëve të tyre në darkë dhe në kulmin e agjërimit është ma e mirë tek Allahu i Madhëruar se aroma e miskut”.** (Edhe mjekësia të thotë se një proces i jashtëzakonshëm ndodh në organizëm gjatë ditës së agjërimit.

Ti ripërtërihesh, pastrohesh nga qelizat e vdekura, ripërtërihet çdo gjë në organizmin tënd. Ti mos u shqetëso për diçka që të duket e bezdisshme se të është bërë goja zeher. Tek Allahu (xh.sh) ky përkushtim dhe ky shqetësim që të trazon ty, konvertohet me më shumë

MESAZHI I MYFTIUT, IMAM MUHAMED B. SYTARI, ME RASTIN E FILLIMIT TË MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT 1444/2023

Lutem me zemër që Zoti (xh.sh) ta begatojë Shkodrën tonë, të jetojmë në paqe dhe harmoni me njëri-tjetrin, të dëshmohemi si njerëz përparimtarë dhe elita, që udhëzojnë drejt më të mirës duke e jetuar të mirën fillimisht në vetvete, duke e përhapur atë në shoqëri dhe duke u bërë rrezatues të çdo të mire për këdo me të cilën jetojmë dhe me të cilin takohemi në këtë jetë kalimtare.

Të dashur dhe të shtrenjtë vëllezër dhe motra besimtarë!

Me zemër të mirë muajin e begatë të Ramazanit.

Elhamdulilah, me mbarësinë dhe bekimet e Allahut, ditën e nesërme, më 23 mars 2023 nisim agjërimin e muajit të begatë të Ramazanit.

Me këtë rast ju uroj të gjithëve me zemër, edhe lutem që të jetë sa më i mbarë dhe sa më i begatë për gjithësecilin prej jush. Të përpiqemi ashtu siç na mëson Pejgamberi (a.s), që të përkushtohemi maksimalisht ndaj Zotit tonë, ndaj adhurimit, besimit, ndaj bamirësisë, ndaj solidarizimit me njerëzit në nevojë me sa të kemi mundësi, në këtë muaj të begatë, që është pikënisje e çdo të mire për jetën tonë, për familjen e për shoqërinë tonë.

Lutem me zemër që të gjithë ne të kthehemi nga Kur’ani Famëlartë, i cili ka nisur të zbresë në këtë muaj të madhërishëm të Ramazanit, për të cilin Zoti i Gjithësisë urdhëron dhe thotë: “Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin nisi të zbriste Kur’ani.” Le të kthehemi nga mësimet e librit të Zotit tonë! Le ta përqafojmë me zemër!

Mos të na pluhuroset Kur’ani në sirtarët e shtëpive tona. Të kthehemi nga udhëzimi hyjnor për të jetuar në harmoni dhe paqe me njëri-tjetrin, për të shpërndarë mëshirë siç e presim mëshirën nga Zoti jonë, për të shpërndarë falje për të tjerët, siç e presim atë nga Zoti jonë, për tu dëshmuar të gjithë së bashku si njerëz të Zotit, që jetojnë në këtë kohë, në jetën e tyre.

Lutem me zemër që Zoti (xh.sh) ta begatojë Shkodrën tonë, të jetojmë në paqe dhe harmoni me njëri-tjetrin, të dëshmohemi si njerëz përparimtarë dhe elita, që udhëzojnë drejt më të mirës duke e jetuar të mirën fillimisht në vetvete, duke e përhapur atë në shoqëri dhe duke u bërë rrezatues të çdo të mire për këdo me të cilën jetojmë dhe me të cilin takohemi në këtë jetë kalimtare.

Me zemër të mirë muajin e Madhërueshëm të Ramazanit. Përhapeni të mirën dhe dëshmojeni gëzimin e madh të kësaj stine të mëshirës dhe faljes që po na vjen.

E gëzofshim së bashku!

se sa era e miskut).

3. Melekët kërkojnë falje për të gjithë agjëruesit në çdo ditë dhe çdo natë. (Sa herë që ti shkon dhe vjen në xhami, çdo ditë që del në punë për t'u lodhur, për të fituar me djersen e ballit, për të ushqyer familjen tënde, rropatesh për qëllimet tuja fisnike, duke mbajtur agjërimin, Pejgamberi (a.s) thotë se Allahu ka caktuar melekë, që në çdo hap tëndin, kërkojnë falje për ty!

Dhe përsëri ka njerëz që nuk agjërojnë?! Natën e parë mëshirohen, çdo ditë ka melekë që kërkojnë falje për ta, një shqetësim që ju duket diçka e madhe ia konverton Allahu me diçka të pa përshkueshme).

4. Allahu i Madhëruar urdhëron xhenetin e Tij dhe thotë: "Përgatitu dhe zbukurohu për robërit e Mi, sepse ato po bëhen gati të pushojnë nga lodhja e dynjasë drejt vendit të mirësive të Mia!"

(Nuk ka asnjë Ramazan që nuk përcjellim dikë nga të dashurit tanë. Shpresojmë që Allahu (xh.sh) t'i falë dhe t'i mëshirojë. Kujtojmë këtë hadith të Pejgamberit (a.s): 'Allahu (xh.sh) i ka hapur dyert e xheneteve, dhe i lumi ai që largohet nga kjo botë në Ramazan, sepse dyert e xheneteve janë të hapura dhe janë zbukuruar enkas për ato të cilët largohen nga kjo botë për të pushuar në vendin e mirësive dhe begative të Allahut nga lodhja dhe rropatja në këtë botë kalimtare.')

5. (Nata e parë e Ramazanit është mëshirë për të gjithë. Po nata e fundit?) Thotë pejgamberi (a.s): **"Në natën e fundit Allahu i Madhëruar i falë krejt ata".** Në natën e parë i mëshiron, në natën e fundit i falë krejt. Pash Allahun a dëgjoni?! A keni parë një ofertë më të madhe, më të begatë dhe më të dashur për shpirtrat tanë se sa kjo që i paraprin muajit të madhërueshëm të Ramazanit.

I tha dikush: **“Ja Resulullah! Kjo nata e fundit, a është Nata e Kadrit për të cilën thuhet se është më e mirë se një mijë muaj? Tha: Jo. Ajo është diçka tjetër. A i keni parë punëtorët që punojnë dhe në fund marrin shpërblimin!”**

Të dashurit e mi!

Nuk mundemi t’i përkufizojmë veçoritë e Ramazanit dhe begatitë e tij me një hytbe 10-15 minuta.

A nuk i keni parë kur punëtorët punojnë, dhe në fund marrin shpërblimin e tyre? Ti punon tërë muajin dhe në fund të del rroga. Ti ke për të agjëruar krejt muajin e madhnueshëm të Ramazanit dhe të jesh i bindur se në natën e fundit që i paraprinë Bajramit, Allahu (xh.sh) të ka vulosur me vulën e magfiretit të Tij, faljes së Tij.

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Me zemër të mirë muajin e Madhnueshëm të Ramazanit! dhe siç thotë Pejgamberi (a.s) në hadithin e Imam Tabaraniut: “Tregojini dhe dëshmojini Allahut më të mirën nga vetja juaj!", duke u përkushtuar në hak të Kur’anit, në hak të namazit, të vëllazërisë tonë islame, në hak të familjes, të dëshmimit të Islamit gjithandej pa ndrojtje me këdo, musliman dhe jo vetëm.

Ejani të përfitojmë nga mirësitë e pafund të këtij muaji të begatë që elhamdulilahi Rabil-alemin po vjen!


I lutemi Allahut që të na bëjë nga ata, që e presin me zemër të mirë dhe me zemër të bardhë, për t'u dëshmuar mirësia, paqtimi i zemrave, falja, tolerimi, në çdo ditë dhe në çdo natë të këtij muaji të begatë.

Allahu ju dashtë dhe ju begatoftë!

Me zemër të mirë muajin e Madhnueshëm të Ramazanit dhe mirë u takofshim në natën e parë të teravisë në xhaminë e Parrucës!

(Hytbeja e xhumasë e mbajtur në xhaminë e Parrucës, më 17 mars 2023)

Diktoi: **Siditë Hafizi**



Shejkh Muhamed El-Gazali

A ËSHTË KY MUAJ, MUAJ I AGJËRIMIT APO MUAJ I USHQIMIT?!

Islami e ka legjitimuar (obliguar) agjërimin për njerëzit, që t'i mësojë komandimin e epsheve të tyre, jo t'i nënshtrohen (t'i binden) atyre!

Ekziston ndryshim mes agjërimit, të cilin e ka urdhëruar Allahu dhe agjërimit, të cilin e bëjnë myslimanët sot. Nuk duam të filozofojmë, por ymeti jonë përballet me një realitet të tillë dhe prej tij kërkojmë të përgjigjet me çiltërsi: A është ky muaj, muaj i agjërimit apo muaj i ushqimit?!

Nëse njeriu përgjatë vitit, futë në barkun e tij tre kilogram ushqim dhe pije në ditë, pastaj vjen muaji i Ramazanit, e ai ndërkohë ka uri dhe etje të madhe... për të ngrënë shumë dhe për të pirë shumë, dhe i cili futë në barkun e tij katër kilogram ushqim dhe pije në ditë apo tre kilogram e gjysmë për shembull, a konsiderohet se ky njeri ka agjëruar, ndërkohë që ai e ka shtuar ushqimin e përditshëm në barkun e tij, që e ka konsumuar gjatë vitit?

Ndërkohë, që njeriu duhej të anonte nga gjysma e tij e sipërme dhe karakteristikat e tij qiellore; të bënte një paqe të përkohshme me betejën e bukës, e cila është e përhapur gjithandej, nga Lindja në Perëndim, dhe rrotull së cilës sillen njerëzit dhe nuk mbaron zhurma e tyre.

Njerëzit sot i shërbejnë trupave të tyre me fuqi e me pasion.

O shërbëtor i trupit, sa po nxiton në shërbim të tij

A po e kërkon fitimin, me gjithë humbjen që ka në të

Drejtoju vetes dhe plotësoji virtytet e saj

Sepse, ti me shpirt, jo me trup, je njeri!

Ne nuk i shpallim luftë trupit, por duam që njeriu të mos jetë skllav i trupit, as shërbëtor i epsheve dhe as i burgosur në çarkun e instinkteve të dynjasë, në të cilat kanë rënë njerëzit dhe me të cilat i ka mashtruar civilizimi i ri, që të mos i tejkalojnë ato, dhe kjo është gabim!!"

Disa kanë frikë se mos gëlltisin një pikë ujë e të prishin agjërimin e tyre...

E, nuk kanë frikë të gëlltisin të drejtat e njerëzve dhe të prishin ahiretin e tyre!

* * *

Agjërimi është vështirësi e kufizuar për të stërvitur njerëzit për morale të larta dhe për t'i mësuar ata si të bëjë mirë dhe të lënë të keqen, apo si të përmallohen për të qenë të qëndrueshëm, të urrejnë të shëmtuarën, ose si të nxitojnë drejt kënaqësisë së Allahut dhe të ikin nga zemërimi i Tij...?!

* * *

Muaji i Ramazanit nuk është betejë e panjohur kundër trupit; por ai është plan i qartë për pastrimin e zemrës, mbështetjen e besimit;

dhe të shpresosh shpërblimin e lodhjes, tek Allahu, e jo tek askush tjetër prej njerëzve!"

Përktheu nga arabishtja:
Lavdrim Hamja



MESAZH FALËNDERIMI NGA MYFTIU PËR BAMIRËSINË SAUDITE ME RASTIN E FILLIMIT TË RAMAZANIT 1444/2023

Ditën e enjte, më 23 mars 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, dha një mesazh falënderimi dhe mirënjohjeje për bashkëpunimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Ambasadës së Mbretërisë Saudite, që mundësuan edhe këtë vit furnizimin me një sasi të konsiderueshme pakosh me ushqime për njerëzit në nevojë, familjet e varfra dhe personat e sëmurë, që vijnë si pjesë e projektit bamirës të Qendrës së Mbretit Selman për Ndihma dhe dhe punë Humanitare.



Në mesazhin e tij, Myftiu tha:

"Myftinia Shkodër, në këtë ditë të begatë të muajit të madhnueshëm të Ramazanit, shpreh falënderimin e saj për Qendrën e Mbretit Selam për Ndihmë dhe punë Humanitare, që në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, bënë të mundur që edhe këtë vit, një sasi e konsiderueshme e pakove ushqimore të mbërrijnë në qytetin tonë, në ndihmë të familjeve nevojtare, skamnorëve, jetimëve, por jo vetëm.

Me këtë rast, duhet të nxisim të gjithë ata bamirës, biznesmenë, besimtarë, që kanë mundësi për të dhënë, për të kontribuuar, dhe të dinë që ky muaj i begatë i Ramazanit është muaj i bamirësisë. Kjo është stina për të dhënë dhe për të ndihmuar të tjerët.

Është mëshira e Zotit (xh.sh) që zbret në zemrat tona, e prej aty shpërndahet tek të tjerët. Është muaji i mëshirës dhe Pejgamberi (a.s), na nxit dhe na porosit që: "Të mëshirueshmit i mëshiron Mëshiruesi; mëshironi ata, që janë në tokë, t'ju mëshirojë Ai, që është në qiell!".

Me këtë rast, unë lutem me zemër, që Allahu (a.xh) ta begatojë kontributin e madh të Qendrës së Mbretit Selam në Arabinë Saudite, atë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, të Myftinisë së Shkodrës, të imamëve, të biznesmenëve, të bamirësve gjithandej, që punojnë në një mënyrë a në një tjetër, për t'i ardhur në ndihmë familjeve në nevojë, skamnorëve, jetimëve, nevojtarëve, të sëmurëve, njerëzve me probleme, dhe së bashku me ndihmën e Allahut (a.xh) përpiqemi të bëjmë më të mirën, për të kapërcyer momentet e vështira të jetës sonë.

Allahu ju dashtë dhe me zemër të mirë muajin e Begatë të Ramazanit!"









NGJARJE NË RAMAZAN 9 RAMAZAN 212



9 Ramazan 212 H - 31 mars

Si sot, në këtë datë të kalendarit Hixhri, ekspeditat e para myslimane zbarkuan në ishullin e Sicilisë dhe myslimanët e sunduan atë për më shumë se 200 vite. Gjatë kësaj periudhe ata arritën të ndërtojnë një qytetërim dhe lulëzim, që u shtri në tërë jugun e Italisë.

Ngjarje në Ramazan

9 Ramazan 212 H - Myslimanët zbarkuan në Sicili të Italisë.

Në ishullin e Sicilisë ndodhen disa trazira mes bizantinëve. Guvernatori i ishullit, Euphemios i kërkoi ndihmë emirit Zijadullah El-Eglebi, duke i ofruar, si shpërblim, sundimin e ishullit.

Ai caktoi në krye të ushtrisë, Esedullah in Furatin, për t'u nisur drejt ishullit të Sicilisë. Ekspeditat myslimane zbarkuan në këtë ditë të Ramazanit (9 Ramazan 212) dhe ky ishte fillimi i një sundimi, që zgjati dy shekuj.

(El-Xheziretu fi Ramadan)



PËRSE I KËRKOJMË INTELEKTUALËT E MËPARSHËM?



Evans Drishti

Ata e kishin kuptuar me kohë se marrja e një diplome mbetet vetëm një hap i parë drejt udhës së gjatë në plotësimin e një karriere, e cila natyrshëm kërkon vizione dhe pikëpamje të depërtueshme në terren.

Trupmëdhenj... Hijerëndë... Shtatlartë... Fisnikë... Njerëz me paraqitje dinjitoze dhe shije ëmbël... Largpamës...

Ecjet e tyre plot finesë dhe njerëzillëk. Ndrisnin fytyrat e tyre, s'njihnin moshë, pasi mendjet i kishin tejet të mprehta dhe të freskëta. Sytë që u vezullonin shprehnin shumë, shumë më tepër se ç'mundohej njeriu të kuptonte përtej tyre. Sytë që shihnin gjithnjë përtej, përtej asaj që mund të shihej në të zakonshmen. Buzëqeshjet e tyre tepër domethënëse, joshëse, që s'kishin se si mos të të bënin për vete... Mallëngjehej njeriu në të tilla raste...

Bisedat e tyre ishin shumë me vlerë, domethënëse, plot delikatesë dhe logjike... Ishin fjalëmbël dhe tregoheshin mjaft të kujdesshëm në përzgjedhjen e frazave. Fjalët e tyre kishin peshë, pasi mendjet e tyre të mprehta peshonin, shumë më tepër se ç'peshonte edhe floriri...

Një jetë e tërë në profesionin e arsimit, natyrshëm të kulluar si në profesion ashtu edhe në jetë. Njohës të shkëlqyer të terminologjisë pedagogjike e arsimore, por jo vetëm...

Profesionin e tyre e kryenin me plot përkushtim, megjithëse shkonin shumë përtej kësaj, pasi për nga intelekti që zotëronin ishin më shumë se akademikë të fushave përkatëse. Shfaqnin përherë sjellje dhe komunikime shumë fisnore mes kolegësh, por po aq fisnore dhe njerëzore edhe mes nxënësish, studentësh, prindërish e dashamirësish, të cilët një tjetër respekt gëzonin për intelektualitetin dhe paraqitjen e tyre profesionale.

Një diapazon shumë të gjerë zotëronin, pasi ishin shumë të kulturuar. Ishin munduar tërë jetën të mos ngelnin të kufizuar thjesht dhe vetëm në një drejtim, prandaj vizionet dhe koherencat i shoqëruan përherë, pasi ata lexonin, shkruanin, kuptonin, gjykonin, depërtonin në mendjet e të tjerëve, reflektonin urtësi dhe maturi...

Dinin sepse lexonin...

Jo vetëm lexonin, por edhe kuptonin, gjykonin dhe aftësoheshin në të kuptuarin e gjërave të ndryshme, qofshin këto edhe zanate. Ishin mjeshtër në rrobaqepësi, publicistikë, laborator, muzikë, artizanat... Kishin fituar prej vitesh shije mjaft të holla për eksperienca të larmishme. Ta kishte ënda t'i shihje me sa kujdes e përkushtim punonin, teksa përherë viheshin në nxjerrje të sa e sa produkteve... Kushdo ngelej jashtëzakonisht i kënaqur nga ajo punë e tyre plot hijeshi, sepse aty kishin dhënë shpirtin e tyre, pasi puna u jepte një kënaqësi të paparë... Dukeshin të tjetër njerëz...

Kishin pikëpamje të qarta për jetën dhe vlerat jetësore. Ishin aspirues të denjë të një kulture të gjithanshme, teksa mishëronin në vetvete të gjitha vlerat njerëzore dhe kulturën popullore. Tradicionalja dhe bashkëkohorja gërshetoheshin mjaft këndshëm në tiparet e tyre, në karakterin e tyre të qëndrueshëm. Ishin njohës të shkëlqyer të të dyja kaheve dhe i reflektonin më së miri kudo ku ishin të pranishëm.

Ishin bashkëshortë të shkëlqyer, prindër model, familjarë të përkushtuar, persona që reflektonin përherë largpamësi dhe dinjitet kulturor, sa herë që komunikonin si brenda familjes ashtu edhe në shoqëri e kudo ndodheshin Ishin shumë të qartë dhe të kuptueshëm, sa seriozë aq edhe tolerantë, dinin të tregoheshin gjakftohtë në shumë rrethana.

E kuptonin jetën dhe pasqyronin jetiken.

Të tillë qenë disa figura të ndritura të Shkodrës si: Mësues i Popullit Hysen Lohja (i ndjerë) Doktor Fiqiret Bushati (i ndjerë). Honoris Causa Faik Luli (i ndjerë), Prof Islam Dizdari (i ndjerë), Prof Is'hak Ramadani (i ndjerë), Prof Xheladin Sokoli (i ndjerë), Prof Xhavit Drishti (i ndjerë), Mjeshtër Kujtim Alija (i ndjerë) e sa e sa të tjerë

...

Hysen Lohja, Mësues i Popullit, mjeshtër i letrave shqipe, sportist i shquar, fitues i sa e sa medaljeve në sporte të ndryshme, njohës i shkëlqyer i arsimit, kulturës dhe traditës shqiptare...

Bisedat e tyre ishin shumë me vlerë, domethënëse, plot delikatesë dhe logjike... Ishin fjalëmbël dhe tregoheshin mjaft të kujdesshëm në përzgjedhjen e frazave. Fjalët e tyre kishin peshë, pasi mendjet e tyre të mprehta peshonin, shumë më tepër se ç'peshonte edhe floriri...



Doktor Fiqiret Bushati profesor dhe mjek njëherazi, që në gjenezë kishte krijuar një autoritet dhe personalitet të padiskutueshëm jo vetëm në mbarë Shkodrën, por edhe në trevat shqiptare.

Honoris Causa Faik Luli, një mjeshtër i letrave shqipe dhe i gjuhësisë shqipe. Një personalitet i padiskutueshëm dhe një enciklopedi më vete. Autor i shumë botimeve dhe shkrimeve të larmishme...

Prof. Islam Dizdari, një didakt dhe ekspert i shquar i pedagogjisë. Njohës i shkëlqyer i arsimit shqiptar, i kulturës dhe traditës shqiptare, metodist me vlera të rralla. Autor i shumë botimeve dhe artikujve jetikë...

Prof. Is'hak Ramadani, një arsimtar i devotshëm në lëmin e gjuhës Italiane dhe jo vetëm. Një enciklopedi më vete e kulturës dhe traditës popullore si dhe i qytetërimeve të lashta dhe bashkëkohore.

Prof. Xheladin Sokoli, një bibliotekë e shumanshme dhe një kolos i letrave shqipe dhe njohës i shkëlqyer i kokave botërore. Shkurt një enciklopedi e pashtershme.

Prof Xhavit Drishti, qoftë si ekspert i matematikës, qoftë një muzikant i shkëlqyer, qoftë një rrobaqepës mjeshtër, qoftë një intelektual i vlerave të larta profesionale e njerëzore...

Mjeshtër Kujtim Alija, i cili ndërroi jetë pak kohë më parë, eksperti i Dirigjimit, i Festivaleve për fëmijë, i bandave muzikore dhe i sa e sa eventeve thelbësore që ngriti në Shkodër dhe mbarë trevat shqiptare...

Secili prej tyre, e natyrshëm sa e sa të tjerë lanë gjurmë të pashlyeshme në kulturën Shkodrane e shqiptare jo vetëm në fushën e tyre të arsimit, por edhe në shumë fusha të tjera të jetës. Dhanë kontribute të vyera duke u kthyer në personazhe të shumëkërkuar dhe shumëdëshiruar në mbarë masën e gjerë popullore.

Ata e kishin kuptuar me kohë se marrja e një diplome mbetet vetëm një hap i parë drejt udhës së gjatë në plotësimin e një karriere, e cila natyrshëm kërkon vizione dhe pikëpamje të depërtueshme në terren.

Secili prej tyre shënoi epokën e tij duke hedhur themele të patundshme jo vetëm në strukturën arsimore, por duke zhvilluar dhe emancipuar një shoqëri të tërë, e cila pa diskutim u mbetet mirënjohëse gjithnjë...

Ja përse i kërkojmë intelektualët e mëparshëm?...

VAZHDON TRADITA E BUKUR E IFTAREVE TË VËLLAZËRISË ISLAME

Tashmë shtrimi i iftare në xhamitë e Shkodrës, dhe veçanërisht në xhaminë e Parrucës, është kthyer në një traditë të bukur. Atmosfera e Muajit Ramazan në Shkodër zbukurohet me iftaret e vëllazërisë islame, ku besimtarë të xhamive të ndryshme mblidhen së bashku për të çelur agjërimin e ditës.

Kjo traditë e bukur realizohet falë punës së palodhur të imamëve të xhamisë Parrucë, teologëve Durim Kasemi dhe Naim Drijaj, si dhe të bamirësve shkodranë, të cilët nuk hezitojnë të kontribuojnë në shtrimin e këtyre iftareve, por jo vetëm, sepse ata dhurojnë edhe ndihma të ndryshme ushqimore, për familjet në nevojë.

Përpara çdo iftari, që shtrohet për besimtarët, imami ose teologu i ftuar mban një këshillë disa minutëshe për agjëruesit, të cilët janë ftuar të çelin iftarin së bashku.

Myftinia Shkodër falënderon angazhimin e të gjithë imamëve gjatë këtij Muajit të Begatë të Ramazanit, dhe njëkohësisht falënderon të gjithë vëllezërit, të cilët janë përfshirë në këtë traditë të bukur, biznesmenë, e të tjerë, që me kontributin dhe punën e tyre zbukurojnë atmosferën e qytetit me shtrimin e iftareve në xhamitë e Shkodrës.

Allahu i Madhëruar e shpërbleftë me të mira secilin prej tyre, në dynja dhe në ahiret.











VIZITË VËLLAZËRORE E MYFTIUT TË PUKËS ME KËSHILLTARË

Paraditën e së mërkurës, më 1 mars 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt Myftiun e Pukës, H. Gezim Kopani me këshilltarë, në një vizitë vëllazërore.

Gjatë takimit të ngrohtë, u diskutua rreth aktivitetit të dy myftinive, domosdoshmërisë së leximit me urtësi të zhvillimeve të vendit dhe angazhimin pa rezerva në shërbim të vlerave të Thirrjes Islame në vendin tonë.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari e përhajroi Myftiun e Pukës për aktivitetin e larmishëm dhe përpjekjet për të ruajtur gjallërinë e Thirrjes Islame në realitete e kushte të sforcuara e shumë të vështira, njëkohësisht plot



vullnet dhe devotshmëri për t'u marrë shembull.

Në takim u diskutua edhe për aktivitetet që Myftinia Pukë ka planifikuar për Muajin Ramazan dhe bashkëpunimin në këtë drejtim.

MYFTIU VIZITOI SHOQATËN E PARA-TETRAPLEGJIKEVE DEGA SHKODER

Ditën e martë, më 7 mars 2023, Myftiu Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar nga një pjesë e stafit e tij, zhvilloi një vizitë në qendrën e shoqatës së Para-Tetraplegjikë, dega Shkodër, ku u prit nga kryetari i saj, z. Saimir Beqiri.

Fillimisht, z. Beqiri i uroi mirëseardhje të ngrohtë Myftiut Sytari, të cilin e falënderoi me mirënjohje për vizitën dhe për të gjitha kontributet dhe ndihmat e vazhdueshme që Myftinia e Shkodrës ofron në raste të ndryshme për këtë shtresë në nevojë, e cila kërkon një vëmendje dhe përkrahje të vazhdueshme dhe të sinqertë nga të gjitha institucionet.

Sigurisht, se kjo vizitë shërbeu për Mytiun për t'u njohur nga afër me realitetin e kësaj shoqate, e cila sipas kryetarit të saj, përballet me





shumë pengesa dhe neglizhenca të pajustifikueshme nga institucionet përkatëse të kujdesit social, sikurse u njoh edhe me gjendjen e tyre të vështirë ekonomike dhe shëndetësore.

Myftiu nga ana e tij, garantoi se Shoqata e Para-Tetraplegjikëve, dega Shkodër, që drejtohet me shumë përkujdesje nga kryetari, z. Saimir Beqiri, do të jetë pandërprerë në fokusin e aktivitetit humanitar të Myftinisë Shkodër, dhe do të ndihmohet në forma të ndryshme për gjatë gjithë vitit, sidomos në prag të muajit të begatë të Ramazanit 2023.

Në fund të vizitës, Imam Muhamed B. Sytari vizitoi disa ambiente, ku antarët e kësaj shoqate zhvillojnë edhe punë të ndryshme artizanati, edhe si një mundësi ndryshe për shfrytëzimin e kohës dhe dëshmimin e aftësive të ndryshme.

MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI NË XHAMINË KRYESORE TË KËRÇOVËS

Me ftesë të Myftinisë së Kërçovës dhe Myftiut të saj, H. Qamil ef. Rushiti, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ditën e xhuma, më 10 mars 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ligjëroi në xhaminë e Sulltan Bajazit.

Në ligjëratën e tij, Myftiu Sytari u përqendrua tek rëndësia e përgatitjes në prag të muajit Ramazan, duke pastruar nijetin, duke kontrolluar veprat dhe duke u përpjekur për përmirësimin e jetës, mbështetur në udhëzimet kur'anore dhe traditat e Hz. Muhammedit (a.s).

Myftiu i Shkodrës zhvilloi edhe një





vizitë në selinë e Myftinisë së Kërçovës, ku u prit nga Myftiu H. Qamil ef. Rushiti me stafin e tij.

U këmbyen mendime dhe ide në frymën e bashkëpunimit dhe shtrimit të rrugëve të vëllazërisë dhe shfrytëzimit të kohës dhe mundësive për takime dhe aktivitete të përbashkëta.

Në kuadër të kësaj vizite u këmbyen edhe botimet e myftinive përkatëse.





"MIRË SE VJEN O MUAJ I BEKUAR" NJË AKTIVITET ME VLERA NË TUZ

Ditën e hënë, më 13 mars 2023, Meshihati i Bashkësisë Islame në Mal të Zi në bashkëpunim me Myftininë e Shkodrës organizoi ligjëratën për motra me temën: "Mirë se vjen, o Muaj i bekuar", në sallën për konferenca në qendrën Horizonti.

Programi filloi me fjalën përshëndetëse nga Brunilda Kajoshaj, dhe duke vazhduar me ligjëratën nga teologia Ferzet Ndoja.

Programi u shoqërua me ilahi të kënduara nga Selma Bekteshi dhe u prezantua nga profesoresha Vaida Gjokaj.

(marrë nga Radio Fatih – Tuz)









KASHMIRI

Kashmiri, është një rajon në skajin veriperëndimor të nën kontinentit të Indisë, dhe kufizohet me rajonin Autonom Ujgur të Shinxhiang (Xinjiang) në verilindje, me rajonin Autonom të Tibetit në lindje (të dyja pjesë të Kinës), me Indinë në jug, me Pakistanin në perëndim, dhe me Afganistanin në veriperëndim. Ky rajon, që ka një sipërfaqe totale prej rreth 222.200 km katrorë, dhe ka qenë objekt mosmarrëveshjesh midis Indisë dhe Pakistanit, që nga ndarja e nën kontinentit indian në vitin 1947.

Pjesa veriore dhe perëndimore e Kashmirit administrohen nga Pakistani, dhe përbëhen nga tri zona: Azad Kashmir, Gilgit dhe Baltistan, ku dy të fundit janë pjesë e një njësie të vetme administrative të quajtur Gilgit-Baltistan. Nga India janë të administruara pjesët jugore dhe juglindore, 'Xhammu dhe Kashmir' dhe Ladakh. Pjesët e administruara nga India dhe Pakistani, ndahen nga një "vijë kontrolli" për të cilën është rënë dakord në vitin 1972, megjithëse asnjëri prej këtyre dy vendeve nuk e njeh atë si një kufi ndërkombëtar. Përveç kësaj, Kina u bë aktive në zonën lindore të Kashmirit në vitet 1950, dhe ka kontrolluar pjesën verilindore të Ladakh (që është pjesa më lindore e rajonit) që nga viti 1962.

Numri i përgjithshëm i popullsisë së gjithë Kashmirit është afërsisht 20.954.649 banorë, a më shumë (13.635.010 Xhammu dhe Kashmir në Indi; 1.982.720 Gilgit-Baltistan, Pakistan; 5.047.831 Azad Kashmir, Pakistan; 289.088 Ladakh Indi), sipas zhujiworld.com, Mars, 2023.

Muzafferabad është kryeqyteti i Azadi Kashmir-it. Në 'Xhammu dhe Kashmir', **Xhammu** është kryeqyteti dimëror i provincës, kurse Srinagar është kryeqyteti veror i saj.

GJEOGRAFIA

Topografia e Kashmirit është kryesisht malore. Ajo përshkohet kryesisht nga Himalajet Perëndimore. Himalajet përfundojnë në kufirin perëndimor të Kashmirit, në Nanga Parbat. Kashmiri përshkohet nga tre lumenj, përkatësisht Indus, Xhehlum dhe Chenab. Basenet e këtyre lumenjve e ndajnë rajonin në tri lugina, të cilat ndahen nga vargmale të larta. Lugina e lumit Indus formon pjesën veriore dhe verilindore të rajonit, i cili përfshin zona të zhveshura dhe të shkreta të Baltistanit dhe Ladakhut. Pjesa e sipërme e luginës së Xhelumit formon Luginën e Kashmirit,e cila rrethohet nga vargje të larta malore.Lugina e Chenab-it formon pjesën jugore të rajonit të Kashmirit, me kodrat e saj të zhveshura në drejtim të jugut. Ajo përfshin pothuajse të gjithë rajonin Xhammu. Në zonat e larta gjenden liqene të shpeshta. Më poshtë, në luginën e Kashmirit, ka shumë liqene me ujë të ëmbël dhe sipërfaqe të mëdha kënetash, të cilat përfshijnë liqenet Wular, Dal dhe Hokersar, pranë Srinagar-it.



Në veri dhe verilindje, përtej Himalajeve të Mëdha, rajoni përshkohet nga malet Karakoram. Në veriperëndim shtrihet vargmali Hindu Kush. Pjesa e sipërme e lumit Indus ndan malet Himalaje nga ato Karakoram. Malet Karakoram përbëjnë pjesën me akullnajat më të shumta në botë, pas rajoneve polare. Akullnaja Siachen (76 km), dhe akullnaja Biafo (63 km), renditen si akullnaja e dyta dhe e tretë më të gjatat në botë, pas rajoneve polare. Vargmali Karakoram ka katër maja malore që arrijnë në tetë mijë metra lartësi, përfshirë majën K2, që është maja e dytë më e lartë në botë, me 8.611 metër lartësi, pas malit Everest.

Karakteristikat gjeografike të rajonit të Kashmirit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëra pjesë në tjetrën. Pjesa më e ulët e rajonit përbëhet nga fushat e rajonit Xhammu që gjenden në cepin jugperëndimor të vendit, dhe të cilat vazhdojnë në fushat e Punxhabit, në një lartësi nën 300 metra lartësi mbi nivelin e detit. Malet fillojnë në 600 metra lartësi, pastaj ngrihen në 900–1200 metra lartësi, në "Kodrat e Jashtme", një rajon i thyer, me kreshta dhe lugina të gjata e të ngushta. Më pas, brenda trajektores, shtrihen Malet e Mesme, të cilat shkojnë në 2400–3000 metra lartësi, me lugina degëzuese. Ngjitur me këto lartësi, janë vargmalet e larta të Himalajeve (4200 – 4600 metra lartësi), të cilat ndajnë rrjedhat e lumenjve Chenab dhe Xhehlum nga rrjedha e lumit Indus. Përtej këtij vargu malor, shtrihet një trajektore e gjerë e një zone malore, me lartësi prej 5200 – 6700 metrash, në Ladakh dhe Baltistan.

KLIMA


Kashmiri ka një klimë të ndryshme për çdo rajon, për shkak të ndryshimit të madh në lartësi. Temperaturat variojnë nga nxehtësia tropikale e verës së Punxhabit, në të ftohtit intensiv që mban borën e përhershme në male. Zona Xhammu, duke përjashtuar pjesët e sipërme të Luginës Chenab, ka një klimë të lagësht subtropikale. Lugina e Kashmirit ka një klimë të moderuar. Lugina Astore dhe disa pjesë të Gilgit-Baltistanit kanë një klimë gjysmë tibetiane. Po ashtu, edhe Gilgit-Baltistani dhe Ladakhu kanë klimë tibetiane që karakterizohet nga mungesa e shiut.

Kashmiri jugperëndimor, i cili përfshin pjesën më të madhe të provincës Xhammu dhe Muzafferabad, kapet nga munsoni indian. Vargmali Pir Panxhal vepron si një barrierë efektive dhe i pengon këto musone të arrijnë në luginën kryesore të Kashmirit dhe në shpatet e Himalajeve. Këto zona të rajonit e marrin pjesën më të madhe të reshjeve nëpërmjet erërave që fryjnë nga deti Arabik. Shpati i Himalajeve dhe Pir Panxhal përjetojnë shkrirjen më të madhe të borës nga marsi deri në qershor. Shkrirja e borës dhe reshjet, kanë çuar në përmbytje shkatërruese të luginës kryesore.

EKONOMIA

Ekonomia e Kashmirit është e përqendruar rreth bujqësisë. Tradicionalisht, prodhimi kryesor i luginës ishte orizi, i cili përbënte ushqimin kryesor të popullatës. Përveç kësaj, atje rriten edhe misri indian, gruri, elbi dhe tërshëra. Duke pasur parasysh klimën e tij të butë, Kashmiri është i përshtatshëm për kultura të tilla si shpargu, angjinarja, lakra e detit, batha, skarlati, panxhari, lulelakra dhe lakra. Pemët frutore janë të zakonshme në luginë, dhe pemishtet e kultivuara japin dardha, mollë, pjeshkë dhe qershi. Drurët kryesorë që rriten atje janë deodari, bredhi dhe pisha, çinari ose rrapi, panja, mështekna.

Historikisht, Kashmiri u bë i njohur në mbarë botën kur leshi i kashmirit u eksportua në rajone dhe shtete të tjera (eksportet kanë pushuar për shkak të pakësimit të numrit të dhive të Kashmirit, dhe rritjes së konkurrencës nga Kina). Kashmirët janë të aftë në thurjen dhe prodhimin e shalleve Pashmina, qilimave prej mëndafshi, shtrojave, kurtave (këmishë e gjatë dhe e gjerë) dhe qeramikës. Shafrani, gjithashtu, rritet në Kashmir. Srinagar është i njohur për punimet me argjend, papier-mâché (punimet me brumë letre), gdhendjen e drurit dhe për thurjen e mëndafshit.



GJUHA

Gjuha zyrtare e Azad Kashmirit (Kashmirit Pakistanez) është urdishtja. Megjithatë, shumica e popullsisë janë folës amtarë të gjuhëve të tjera, ku më kryesorja e tyre është Pahari-Pothuari me dialektet e saj të ndryshme. Ka gjithashtu komunitete të konsiderueshme që flasin kashmirisht (kryesisht në veri), Guxhari (në të gjithë territorin) dhe Dogri (në jug), si dhe vende të vogla që janë folës të gjuhëve Kundal Shahi, Shina dhe Pashto. Me përjashtim të Pashtos dhe Anglishtes, gjuhët e tjera të folura atje i përkasin familjes së gjuhëve indo-ariane.

Anglishtja është gjuha e huaj më e përdorur në vend.

Në Kashmirin Indian, fillimisht, vetëm urdishtja dhe anglishtja ishin gjuhët zyrtare. Një projektligj i miratuar në vitin 2020, shtoi në listë edhe gjuhët Dogri, Kashmiri dhe Hindi.

Feja

Islami është feja kryesore në Kashmir. 97.16% e popullsisë së rajonit u identifikuan si myslimanë, në vitin 2014.

Popullsia hindu përbën 2.3 %, dhe sikhët 0.81%.

Shumica e popullsisë së Kashmirit përbëhet nga kashmirë etnikë, me një pakicë të konsiderueshme Guxharë dhe Bakarvalë.

HISTORIA

Në mijëvjeçarin e parë të erës sonë, Kashmirin e sunduan një varg dinastish hindu, deri në vitin 1346, kur ra nën sundimin musliman. Periudha e sundimit të muslimanëve atje zgjati gati pesë shekuj, duke përfunduar me aneksimin e Kashmirit nga mbretëria Sikhee Punxhabit, në vitin 1819.


Në vitin 1819, sundimtari Sikh i Punxhabit, Ranxhit Singh, pushtoi Kashmirin dhe e sundoi atë deri në vitin 1846. Ai e bëri të vuante popullin, duke u vënë taksa të tepruara dhe i detyroi njerëzit të punonin pa pagesë. Ai nxori ligje raciste ndaj muslimaneve, mbylli shume xhami, ndaloi faljen e namazeve në to dhe gjaku i muslimanit nën sundimin e tij ishte më i lirë se i gjithçkaje tjetër, në një kohë kur ligji i tyre e konsideronte 'therjen e lopës' si krim te dënuar me vdekje!

Kur Britania mori kontrollin e Indisë - në vitin 1846 - ajo ia shiti Gulab Singh-ut shtetin e Kashmirit, për një shumë prej 5.7 milionë rupish, sipas Marrëveshjes Amritsar, të bërë në Mars të vitit 1846, një ditë pas shpërthimit të luftës së parë mes britanikëve dhe sikhëve. Prem Nath Bazaz, i cili është një nga figurat e njohura politike në Kashmir, e komenton këtë marrëveshje duke thënë: "Dy milionë njerëz në luginën e Kashmirit dhe në Gilgit, u shitën siç shiten delet dhe dhentë, tek një kumarxhi i çuditshëm, pa u pyetur aspak për këtë çështje".

Gulab Singh, nëpërmjet luftës edhe diplomacisë, arriti të merrte nën kontroll rajonin e 'Xhammu dhe Kashmir', përfshirë edhe rajonet e Ladakh, Baltistan dhe Gilgit, dhe krijoi një sistem qeverisjeje për familjen Dogra, e cila e sundoi Kashmirin deri në vitin 1947. Gulab Singh u pasua nga tre sundimtarë: Ranbir Singh (1858), Partap Singh (1885), dhe Harry Singh(1925), i cili ishte edhe sundimtari i fundit i këtij regjimi, deri në datën e ndarjes së nën kontinentit, në vitin 1947.

Vlen të theksohet se Konferenca Myslimane e Kashmirit në atë kohë konsiderohej si përfaqësuesi i vetëm legjitim i popullit mysliman të

12



Xhamia Mbreti Fehd ibn Abdulaziz, Muzaffarabad

Kashmirit. Në zgjedhjet e Janarit të vitit 1947, ata arritën të merrnin 16 vende, nga 21 vende të posaçme për muslimanët në parlamentin e shtetit. Përqindja e muslimanëve në atë kohë ishte më shumë se 85% e popullsisë, kështu që, vendimi i Konferencës së Muslimanëve të Kashmirit për t'iu bashkuar Pakistanit, ishte vendimi i shumicës. Por pavarësisht kësaj, India e aneksoi shtetin me forcë, në kundërshtim me vendimin e ndarjes dhe vullnetin e popullit mysliman të Kashmirit.

Sipas kushteve të rëna dakord nga India dhe Pakistanit për ndarjen e nën kontinentit Indian, sundimtarëve të shteteve princërore u ishte dhënë e drejta të zgjedhin ose Pakistanin ose Indinë, ose - me disa rezerva - të mbeten të pavarur. Hari Singh, maharaxha i Kashmirit, pavarësisht vendimit të Konferencës Muslimane, në Tetor të vitit 1947nënshkroi bashkimin me Indinë. Ky ishte sinjali për ndërhyrje si nga Pakistani, i cili e konsideronte Kashmirin si një zgjatim natyror të Pakistanit, ashtu edhe nga India, e cila synonte të konfirmonte 'aktin e bashkimit'. Lufta vazhdoi përgjatë vitit 1948, dhe me ndërmjetësimin e Kombeve të Bashkuara, përfundoi me një armëpushim, i cili hyri në fuqi në janar të vitit 1949. Në korrik të po atij viti, India dhe Pakistani përcaktuan vijën e armëpushimit - vijën e kontrollit - që ndante administrimin e territorit. Ajo zgjidhje konsiderohej atëkohë si një zgjidhje e përkohshme, por vija e kontrollit që vunë atëherë është në fuqi ende edhe sot.

Sot India ka nën kontroll rreth gjysmën e zonës së ish-shtetit princëror të Xhammu dhe Kashmir ('Xhammu dhe Kashmir', dhe Ladakh), ndërsa Pakistani kontrollon një të tretën e rajonit, të ndarë në dy provinca (Azad Kashmir dhe Gilgit-Baltistan), megjithëse kur u nda, në Kashmir kishte një shumicë të qartë myslimane, dhe afërsia e saj ekonomike, kulturore dhe gjeografike me zonën me shumicë myslimane të Punxhabit në Pakistan, mund të demonstrohej bindshëm. Grupi më i madh mysliman, i vendosur në Luginën e Kashmirit dhe që vlerësohet të ketë më shumë se gjysmën e popullsisë së të gjithë rajonit, shtrihej në territorin e administruar nga India, dhe me ndarjen e vendit, daljet e tyre të mëparshme nëpërmjet rrugës së luginës së Xhelumit, iu bllokuan.

Republika Popullore e Kinës, gjithashtu, kontrollon pjesën verilindore (Aksai Chin dhe Traktatin Trans-Karakoram) të Kashmirit.



Muzafferabadi

SI ERDHI ISLAMI NË KASHMIR

Historia e hyrjes së Islamit në Kashmir daton në shekullin e parë të Hixhretit, nga koha e Muhamed ibn El-Kasim Eth-Thekafij, i cili hyri në Sindh dhe arriti deri në Kashmir. Islami u përhap atje gjatë shekullit të 14-të e.j, kur Rinchan - një sundimtar budist i Kashmirit - hyri në Islam në vitin 1320, nëpërmjet zotërisë Bilal Shah, i njohur si Bulbul Shah, i cili ishte një eksplorues musliman nga Turkistani.

Islami atje u forcua më shumë gjatë sundimit të Shah Mir-it, (vitet 1338 -1344 e.j). Në këtë periudhë, dijetarët myslimanë u bashkuan me radhët e masave popullore për t'u komunikuar atyre fenë e Zotit. Shumica e atyre dijetarëve erdhën nga Azia Qendrore. Nga figurat e shquara të asaj kohe citohet të jetë Ali El-Hamedani, i njohur si Shah Hemedani (i lindur në rajonin e Hemedanit në Iran, në vitin 1314 e.j). Sulmet e forcave të Timur Leng-ut kundër popullsisë në Azinë Qendrore, e detyruan Ali El-Hamedanin të migronte në Kashmir, vend të cilin ai e vizitoi tri herë (në vitet 1372, 1379 dhe 1383), i shoqëruar nga 700 persona nga ndjekësit e tij, dhe arriti të përhapte Islamin në mesin e mijëra banorëve të Kashmirit. Djali i tij, Muhammed El-Hemedani, ndoqi rrugën e të atit, dhe e bindi sundimtarin mysliman të asaj kohe, sulltanin Iskander (1389 -1413) të zbatonte Sheriatin. Sundimtari mysliman, sulltani Zejn El-Abidin, i biri i sulltanit Iskander (1420 -1470), u dallua për tolerancë të madhe ndaj hinduve, dhe në fund të shekullit të 15-të e.j, shumica e popullsisë së Kashmirit kishte hyrë në Islam.

Në shekullin e 16-të (viti 1587), Xhelal Ed-Din Ekber e bashkoi rajonin me Shtetin Mogul, dhe qeverisja myslimane vazhdoi të udhëhiqte atje për afërsisht pesë shekuj (1320-1819). Kjo periudhë konsiderohet "epoka e artë" e historisë së vendit, pasi nën kujdesin e autoriteteve myslimane, populli i Kashmirit gëzonte prosperitet, liri, siguri dhe paqe.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://www.britannica.com
https://en.wikipedia.org
https://islamstory.com
https://zhujiworld.com

NJË DITË E BEGATË NË MESIN E FËMIJËVE TË XHAMISË BARBULLUSH



Paraditën e së martës, më 14 mars 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga Drejtori i Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, zhvilloi një takim të përzemërt me fëmijët e mejtepit të xhamisë së fshatit Barbullush, që drejtohet me shumë përkushtim nga imami i kësaj xhamie, Mr. Ervis Molla.

Gjatë takimit të përzemërt, Myftiu iu drejtua fëmijëve me një këshillë të ngrohtë dhe një urim zemre në prag të Muajit Ramazan 1444.



Poashtu falënderoi kontributet e Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, që ditën e sotme kishte sjellë disa pajisje ngrohëse për Qendrën Kulturore të kësaj xhamie, që u përurua pak muaj më parë.

Nga ana e tij, edhe z. Kaja shprehu kënaqësinë e pranisë së tij në mesin e fëmijëve që i japin gjallni kësaj xhamie, si dhe shprehu gatishmërinë e tij për të qenë përherë afër tyre dhe nevojave të qendrës kulturore.

Takimi vazhdoi me një bashkëbisedim të përzemërt me disa prej pjestarëve të këshillit të xhamisë dhe të rinjve të saj.

PREZANTOHET LIBRI: "POLITIKAT PUBLIKE PËRTEJ JURISPRUDENCËS TRADICIONALE NJË QASJE MEKASID"



Paraditen e të mërkurës, më 15 mars 2023, në ambientet e bibliotekës publike të qytetit, Myftinia Shkodër në bashkëpunim më Institutin e Qytetërimit dhe Mendimit Islam (AIITC), në prag të muajit të begatë të Ramazanit, zhvilloi një veprimtari prezantuese të librit: "Politikat Publike përtej jurisprudencës tradicionale një qasje mekasid", të autores Basma I. Abdelgafar.

Libri u prezantua në praninë e autoriteteve fetare dhe civile, imamëve, të rinjve, studentëve dhe disa maturanteve të medresesë së Shkodrës.

Pas hapjes dhe prezantimit të autores së librit, nga teologu Arben Halluni, fjalën përshëndetëse e mbajti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili fillimisht falënderoi Institutin AIITC për bashkëpunimin në organizimin e këtij aktiviteti kulturor të veçantë, më një libër të veçantë, nga një autore e veçantë, e cila sjell për lexuesit një hapësire të re studimi të Islamit, duke u përpjekur të trajtojë fushën e politikave publike nga qasja mekasid.

Ndërsa, teologu Lavdrim Hamja, u ndal në disa artikuj dhe shkrime interesante dhe të vlefshme për të gjithë, sidomos tek temat: Përcaktimi i dobive dhe i dëmeve, Politikat Publike në Islam/Shteti I Disiplinës, Mbrojtja e Domosdoshmërive në Islam (Feja, Jeta, Mendja, Trashëgimia Njerëzore dhe Pasuria).

Një kumtesë të shkurtër pati edhe përkthyesi i librit, z. Astrit Hykaj, i cili solli në vëmendje momente të rëndësishme të lidhura me përkthimin, por edhe kënaqësinë e tij për të përkthyer një libër me vlera dhe shumë aktuale për jetën njerëzore publike, e cila përballet me padrejtësi të ndryshme ekonomike, sociale, etj.

Në fund të aktivitetit, të pranishmëve iu dhurua libri: "Politikat Publike përtej jurisprudencës tradicionale një qasje mekasid".

"RAMAZAN MUBAREK", TRIBUNË FETARE NË PRAG TË MUAJIT TË RAMAZANIT 1444

Pas iqindisë së ditës së enjte, më 16 mars 2023, në qendrën kulturore pranë xhamisë Kiras, në vigjilje të muajit të madhëruesëm të Ramazanit 1444, Myftinia Shkodër zhvilloi tribunën fetare me temë: "Ramazan Mubarek", me pjesëmarrjen e imamëve, myezinëve dhe këshillave të xhamive të Shkodrës.



Pas fjalën së hapjes nga teologu Arben Halluni, ligjëratën kryesore e mbajti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili tha se atmosfera e begatë e Ramazanit ka filluar të ndjehet në qytet dhe në fshatra, përmes përgatitjes së përgjithshme, pastrimeve, rregullimeve, mesazheve të urta, etj.

Gjatë fjalës së tij, Myftiu dha edhe udhëzime dhe këshilla që kanë të bëjnë me organizimin e të gjitha riteve fetare në xhami dhe përtej saj, zhvillimit të iftareve, derseve, mukabeles/këndimit të plotë të hatmes së Kur'anit Famëlartë dhe të shumë veprimtarive të tjera të dobishme, të cilat duhet të përcillen tek xhemati.

Në fund, Myftiu uroi për një muaj të begatë, plot dritë dhe shpresë si dhe Zoti (xh.sh) ta bëjë këtë muaj reflektim të besimit, të moralit dhe lidhjes më tepër se kurrë me Allahun (xh.sh).

Në vijim, H. Naim Drijaj, imam i xhamisë Parrucë mbajti një kumtesë, duke u ndaluar mbi domethënien e ajeteve të agjërimit, rëndësinë, vlerat, dobitë shpirtërore, morale dhe fizike që ka agjërimi dhe Ramazani në përgjithësi.

Ndërsa, H. Ensar Smajlaj, imam i xhamisë së Dërgutit, në kumtesën e tij u fokusua në mënyrën e davetit/thirrjes islame nga imamët në xhaminë që shërbejnë, rritjen e angazhimit për të solidarizuar sa më shumë bamirës gjatë këtij muaji të begatë ndaj shtresave në nevojë, skamnorëve etj.

Në fund të takimit, u shpërndanë posterat dhe kalendarët e Ramazanit, si dhe numri i ri i sapo dalë, i gazetës së Myftinisë Shkodër, "Udha Islame".



MBYLLET CIKLI I PESTË I LIGJËRATAVE PËR MOTRAT NË XHAMINË "EBU BEKËR"

Ditën e xhuma, pas iqindisë, më 17 mars 2023, u zhvillua aktiviteti përmbyllës i ciklit të pestë tremujor i ligjëratave javore "Adhurimi, një përjetim gjithëpërfshirës" në xhaminë Ebu Bekër, i mbajtur për motrat nga teologia Msc. Zamira Bushati – Puka.

Gjatë këtyre javëve u trajtuan shumë tema të ndryshme fetaro-psikologjike, ku një rëndësi të madhe iu dha dimensioneve shpirtërore, trupore, psikologjike dhe praktike të adhurimit, me qëllim që ta përjetojmë atë më tepër.

Gjithashtu u trajtuan tema për Isranë e Miraxhin, për rëndësinë e muajit Rexheb e Shaban, për namazin e për qëllimin e tij, dhe si të përgatitemi për të shijuar një Ramazan sa më të begatë.

Në këtë aktivitet kulturoro-fetar, i ndërthurur me ilahi e poezi, u mbajt ligjërata me temë: "Dimensione





Ramazani", nga teologia Zamira Bushati. Gjithashtu në mbyllje të tij u bë edhe duaja e Hatmes së Kur'anit.

Në fund u bë edhe shpërndarja e planifikuesit dhe kalendarit të Ramazanit.

Një falënderim i veçantë i takon organizatorëve, sidomos vajzave të reja, të cilat u bënë pjesë e këtij cikli.

MYFTIU FALËNDERON BASHKINË SHKODËR PËR ZBUKURIMET E QYTETIT PËR RAMAZAN!?

Nga minberi i xhamisë së Parrucës, më 17 mars 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Muhamed B. Sytari, gjatë hytbes së xhumasë, ndër të tjera bëri edhe një falënderim publik për Bashkinë e Shkodrës, ku ndër të tjera tha:

"Pas sa e sa thirrjeve që i kemi bërë institucionit të bashkisë, ajo ka nisur të zbukurojë rrugët e qytetit të Shkodrës që të ndjehet atmosfera e Ramazanit, siç ndjehet atmosfera e festave të tjera një ditore, me nga një muaj para e pas..!?

Ta falënderojmë përzemërsisht institucionin e bashkisë, që në çdo lagje të qytetit po vendos fenerë ndriçues, si dhe po zbukuron rrugët për t'u ndriçuar Shkodra në këtë Ramazan!

Pastaj, duhen falënderuar tregtarët, që po ulin çmimet se po vjen Ramazani dhe po e bëjnë këtë duke dëshmuar shpirtin e këtij sihariqi të madh, duke vendosur pankarta, çdo firmë dhe dyqan, duke uruar njerëzit me rastin e këtij mubareku Ramazan në këtë qytet mysliman, për t'u ndjerë atmosfera e shpirtit islam, pa ndrojtje dhe pa hezitim dhe për t'u kapërcyer pragu i asaj politike të kalbur, që në këto 30 vite të fundit sikur ka gërmuar në genet e qytetarëve e këtij vendi për të vazhduar atë punë që bëri sistemi komunist për t'a spastruar identitetin e shqiptarëve nga Islami!?



Ndërkohë Allahu (xh.sh) thotë në Kur'anin Famëlartë: "Ju nuk duhet të ndjeheni inferiorë dhe nuk duhet të keni frikë e ndrojtje, sepse jeni besimtarë!"

Shpresojmë dhe lutemi që ky falënderim të jetë sa më real dhe Shkodra të mos ngelet një qytet topall, përsa i përket zbukurimeve me rastin e festave fetare dhe mesazheve që ato përcjellin në masë!

CEREMONI FESTIVE NË MYFTININË E PUKËS, NË KUADËR TË 100-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SAJ

Ditën e shtunë, më 18 mars 2023, në kuadër të 100-vjetorit të themelimit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Myftinisë së Pukës, si dhe njëherazi në prag ardhjes së muajit të Bekuar të Ramazanit, Myftinia Pukë, zhvilloi një simpozium në pallatin e kulturës së këtij qyteti.

Të pranishëm ishin Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Myftiu i Pukës, Gëzim Kopani, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i Deleguari i Myftiut të Republikës së Kosovës, njëherazi edhe Kryetar i KBI-së Gjakovë, Valon Myrta, Kryetari i KBI-së Prizren, Besim Berisha, mysafirë nga qyteti i Tetovës si dhe besimtarë të shumtë.

Simpoziumi u çel me lexim Kur'ani nga imami Ramiz Mziu, për të vijuar me fjalën hapëse të Myftiut të Pukës, Gëzim Kopani.

Më tej, të pranishmit i përshëndeti Kryetari Spahiu, i cili pasi falënderoi organizatorët për këtë aktivitet, ndau me të pranishmit disa mesazhe të rëndësishme të këtij viti jubile të KMSH-së, për ta mbyllur me një urim kushtuar muajit të begatë të Ramazanit.



Ky simpozium vazhdoi më tej me referimin e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytari dhe Myftiut të Vorës, Baftjar Këllezi.

Në të njëjtën ditë, Myftinia Pukë, nën kujdesin e Myftiut Kopani, zhvilloi aktivitetin jubilar me titull: "100 Vjet Myftinia Pukë"

Kjo ceremoni u hap me këndimin e himnit kombëtar, për të vijuar me një dokumentar të përgatitur nga Myftinia Pukë me këtë rast.

Më pas, aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Pukës, i cili u shpreh se ky aktivitet jubilar zhvillohet në shenjë mirënjohjeje për kontributin që hoxhallarët e mëparshëm kanë dhënë për themelimin e Myftinisë Pukë, duke filluar nga Hafizi Xhemal Naipi, Zenel Hoxha, Sadik Prishtina, Qazim Nushi, etj, si dhe për të gjithë institucionet, fondacionet apo individët që kanë mbështetur dhe vijojnë ta mbështesin myftininë tonë.

Me këtë rast, Myftinia Pukë shpërndau disa certifikata mirënjohjeje për familjet e hoxhallarëve dhe fondacionet që kanë mbështetur Myftininë ndër vite.

MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI NË TRIBUNËN E ORGANIZUAR NGA KB ISLAME NË FERIZAJ

Një natë e madhe dhe e paharruar, në mesin e vëllezërve të mirë në Ferizaj, bashkë me kryetarin e KB Islame, H. Nexhmedin ef. Bajrami, "babain e jetimëve", H. Halil Kastrati, ilahistin e dashur, H. Adem Ramadani, këndueesin e Kur'anit, H. Avdush ef. Krosa, imamin e nderuar, H. Mustafë ef. Mehmeti dhe dashamirësinë e papërshkrueshme të besimtarëve të shtrenjtë në xhaminë qendrore atje. Allahu jua shpërbleftë!"



Kështu shkruan Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në një postim



në rrjetet sociale, në lidhje me aktivitetin e organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Ferizaj, ditën e hënë, me 20 mars 2023, pas namazit të akshamit, në xhaminë e madhe "Mulla Vesel Guta".

Në praninë e besimtarëve të shumtë, që kishin tejmbushur xhaminë, brenda dhe jashtë, Myftiu i Shkodrës ligjëroi rreth kuptimeve dhe thelbit të agjërimit të Ramazanit.

Emocione të shumta dhuroi veprimi i humanistit të shquar në trojet shqiptare dhe përtej, Halil ef. Kastrati, si dhe këndimet e të nderuarve H. Avdush Krosa dhe H. Adem Ramadani.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Kryetari i KBI Ferizaj, H. Nexhmedin ef. Bajrami dhe imami i nderuar, H. Mustafë ef. Mehmeti.

Më herët, Myftiu zhvilloi edhe një vizitë në selinë e KBI Ferizaj, ku u prit nga Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Ferizaj, H. Nexhmedin ef. Bajrami me staf.

MYFTIU TAKOI KRYETARIN E BASHKISË VAU DEJËS

Paraditën e së martës, më 21 mars 2023, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune në Bashkinë Vau Dejës, ku u prit nga Kryetari i saj, Mark Babani me staf.



Gjatë bashkëbisedimit të ngrohtë, u diskutua rreth bashkëpunimit të përbashkët në interes të ruajtjes së vlerave dhe shenjtërive, si dhe mirëkuptimin në raport me tema me interes të përbashkët për të dy institucionet.

Myftiu Sytari e falënderoi Kryebashkiakun Babani për frymën e bashkëpunimit dhe uroi që falë kësaj fryme, projektet me vlerë për komunitetin të mos ngelen peng e asnjë burokracie, jashtë dëshirës dhe vullnetit të mirë të dy instutucioneve.

MEJTEPI IM... XHAMIA SHIROKË

Pak histori:

- Xhamia Shirokë, ndodhet në Njësinë Administrative të Bashkisë Shkodër.

- Aktualisht, përbëhet prej rreth 350 familjeve myslimane.

- Familjet më të vjetra janë: Rama, Sukraja, Ahmeti, etj.

- Ndërtimi i xhamisë së parë thuhet se është i hershëm, në shekullin e 18-të. Me ndërtimin e xhamisë është ndërtuar edhe mejtepi, i cili u prish në vitin famëkeq 1967, ndërsa xhamisë iu prish minarja dhe u kthye në shtëpi banimi.

Ndërsa, në vitin 1990 besimtarët myslimanë të Shirokës e morën përsëri





xhaminë dhe bënë riparimin e saj me kontributin e banorëve dhe të Myftinisë Shkodër. Minarja e re u ndërtua në vitin 2010 me kontributin e z. Bari Çela dhe haxhi Osman Vataksi.


- Imamët e xhamisë Shirokë, njëkohësisht edhe mësues të mejtepeve që kanë shërbyer gjatë këtyre viteve dhe në vazhdim janë: Ramadan Dul Plisi, Ylber Rrupa, Ervin Ismaili, Ozxhan Acikiz, Bendis Hoxha dhe imami aktual Ardit Hoxha.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 14 mejtepe dhe kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në këtë xhami nga viti 2002-2023 është rreth 320 nxënës.

Takimi me nxënësit:

Në vazhdën e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset/mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi më 25 mars 2023 një takim me nxënësit e mejtepit/kursit fetarë të xhamisë Shirokë, me praninë edhe të mësuesit Ardit Hoxha.

Drejtuesi i arsimit, pasi u njoh me ecurinë e procesit mësimor, zbatimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve etj, u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit Fuqiplotë.



HËNA E RE E RAMAZANIT 1444, VJEN ME DRITË E BEKIME NË SHKODËR!

Me mbarësinë e Allahut, me hyrjen e akshamit të ditës së mërkurë, më 22 mars 2023, në horizontet tona u shfaq edhe Hëna e re e Muajit Ramazan 1444.

Në Shkodër, gëzimi për fillimin e Ramazanit është i madh. U ndriçuan xhamitë, u gëzuan pleq e të rinj, u mbushën shtëpitë e Allahut me besimtarë dhe, kështu nisi teravia e parë dhe përgatitjet për agjërimin e ditës së parë, të enjten, më 23 mars 2023.

Falë përkushtimit të stafit të Myftinisë Shkodër, sheshi i Parrucës dhe xhamia e saj, u zbukuruan me ndriçimin e Ramazanit, duke dhuruar emocione dhe kënaqësi për besimtarët dhe kalimtarët e shumtë.

Ndërkohë, në prag të namazit të teravisë së parë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua besimtarëve me një urim dhe këshillë, shoqëruar me lutjen që Allahu i Madhëruar ta lehtësojë dhe ta pranojë nga të gjithë.






Myftinia Shkodër, ju fton të respektoni e të madhëroni këtë Muaj, të përkushtoheni me agjërim, falje e bamirësi, harmoni në familje dhe tolerancë.

Allahu jua lehtësoftë dhe me zemër të mirë Ramazanin!














MYFTIU I SHKODRËS VIZITOI SHTËPINË E TË MOSHUARVE "JETIMAT E BALLKANIT" NË KOSOVË



Me ftesë të humanistit të shquar, H. Halil Kastrati, ditën e mërkurë, më 29 mars 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë në ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve "Jetimët e Ballkanit", në Republikën e Kosovës.

Në krye të herës, Myftiu vlerësoi punën e paçmuar të humanistit më të shquar të trojeve shqiptare, Hoxhë Halil Kastrati, bamirësitë e të cilit janë të panumërta dhe rrezatojnë shpirtin e pastër të mësimeve dhe vlerave tona islame, që përhapen në mbarë kombin tonë dhe përtej.

Pas bisedës së ngrohtë dhe vëllazërore, Myftiu vizitoi edhe të moshuarit rezidentë në këtë qendër të pashembullt, sikurse mbajti edhe një bisedë të shkurtër, duke folur mbi rolin e përkujdesjes për moshën e tretë në Islam.

Myftiu Sytari vlerësoi punën e madhe të humanistit Kastrati dhe theksoi se shembulli i tij na bën të gjithëve krenar!








9 MILION NAMAZLI DHE UMREXHI GJATË RAMAZANIT

Kryesia e Çështjeve të Dy Xhamive: 9 milion namazli dhe umrexhi, që nga fillimi i muajit të Beqatë të Ramazanit.

ARABIA SAUDITE:

Kryesia e Çështjeve të Dy Xhamive thotë, se numri i atyre, që kanë vizituar Qaben e Madhërueshme, prej umrexhive dhe vizitorëve, ka arritur 9 milion dhe 357 mijë namazli dhe umrexhi, gjatë dhjetë ditëve të para të muajit të Beqatë të Ramazanit.



Duke lënë të kuptojnë për shërbimet e ndryshme, që u ofrojnë vizitorëve, prej shpërndarjes së ujit të Zemzemit, shto këtu edhe ndërgjegjësimit digjital dhe shërbimet e tjera të tavafit.

(El-Xheziretu fi Ramadan)



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

MYFTINIA SHKODËR

Ramazan 1444

Kalendar 23 MARS - 20 PRILL 2023

21 prill 2023 - Fitër Bajrami | Namazi i Bajramit falet në 06:42

1 RAMAZAN	SYFYRI 4:04 IFTARI 18:04	23 MARS	11 RAMAZAN	SYFYRI 4:45 IFTARI 19:15	2 PRILL	21 RAMAZAN	SYFYRI 4:25 IFTARI 19:25	12 PRILL
2 RAMAZAN	SYFYRI 4:02 IFTARI 18:05	24 MARS	12 RAMAZAN	SYFYRI 4:43 IFTARI 19:16	3 PRILL	22 RAMAZAN	SYFYRI 4:23 IFTARI 19:27	13 PRILL
3 RAMAZAN	SYFYRI 4:00 IFTARI 18:06	25 MARS	13 RAMAZAN	SYFYRI 4:41 IFTARI 19:17	4 PRILL	23 RAMAZAN	SYFYRI 4:22 IFTARI 19:28	14 PRILL
4 RAMAZAN	SYFYRI 4:58 IFTARI 19:07	26 MARS	14 RAMAZAN	SYFYRI 4:39 IFTARI 19:18	5 PRILL	24 RAMAZAN	SYFYRI 4:20 IFTARI 19:29	15 PRILL
5 RAMAZAN	SYFYRI 4:56 IFTARI 19:08	27 MARS	15 RAMAZAN	SYFYRI 4:37 IFTARI 19:19	6 PRILL	25 RAMAZAN	SYFYRI 4:18 IFTARI 19:30	16 PRILL
6 RAMAZAN	SYFYRI 4:54 IFTARI 19:09	28 MARS	16 RAMAZAN	SYFYRI 4:35 IFTARI 19:20	7 PRILL	26 RAMAZAN	SYFYRI 4:16 IFTARI 19:31	17 PRILL
7 RAMAZAN	SYFYRI 4:52 IFTARI 19:10	29 MARS	17 RAMAZAN	SYFYRI 4:33 IFTARI 19:21	8 PRILL	27 RAMAZAN	SYFYRI 4:14 IFTARI 19:32	18 PRILL
8 RAMAZAN	SYFYRI 4:50 IFTARI 19:11	30 MARS	18 RAMAZAN	SYFYRI 4:31 IFTARI 19:22	9 PRILL	28 RAMAZAN	SYFYRI 4:12 IFTARI 19:33	19 PRILL
9 RAMAZAN	SYFYRI 4:49 IFTARI 19:13	31 MARS	19 RAMAZAN	SYFYRI 4:29 IFTARI 19:23	10 PRILL	29 RAMAZAN	SYFYRI 4:10 IFTARI 19:34	20 PRILL
10 RAMAZAN	SYFYRI 4:47 IFTARI 19:14	1 PRILL	20 RAMAZAN	SYFYRI 4:27 IFTARI 19:24	11 PRILL	1 SHEVAL	FITËR BAJRAMI	21 PRILL

- Nata e Kadrit, e hënë, më 17 prill 2023 | Duaja: **"O Zoti im, Ti je Falës, e do faljen, më fal mua!"**

- Falja e Sabahut në xhami bëhet 30 minuta pas Imsakut (Syfyrit) | *Oraret janë referuar zonës së Shkodrës*

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek